



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT**  
**OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN**

C.nr. 958/13

**GJYKTA THEMELORE NË PRIZREN** gjyqtarja Shpresa Emra,në çështjen civile të paditëses Sh. R. nga fsh.K. Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson F. Ç. Komuna e Prizreni, kundër të paditures KS "Sigal" nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson K. P. nga Prishtina, për kompenzim dëmi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, më dt.13.03.2014 mori

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Sh. R. nga fsh. K. Komuna e Prizrenit, si e bazuar, **OBLIGOHET** e paditura KS "Sigal" nga Prishtina, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, për fitimin e humbur për shkak të paaftësisë punuese të paguaj rentën e kapitalizuar në shumë prej **9.258,87 €** të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me dt. 04.08.2006, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë Bankat komerciale në Kosovë për mjetet e afatizuara duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit gjer te pagesa definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

**II. OBLIGOHET** e paditura KS "Sigal" nga Prishtina që të paguaj shpenzimet procedurale në shumë **360€** të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

**Pretendimet e palëve**

Paditësja respektivisht e autorizuara e saj, me padi dhe sipas kërkesë padisë së precizuar ka cekur se më dt. 04.08.2006 është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, në të cilën lëndime trupore të rënda kanë pësuar Sh. R., B. R. dhe J. R. që të gjithë nga fsh.K. Komuna e Prizrenit. Si shkaktar i aksidentit kanë qenë vozitësit e automjetit "Golf 2" dhe "Fiat Ducato" kurse ngasësi i automjetit "Golf 3" paditësi B. R. në këtë rast dhe bashkudhëtarët e tij Sh. R. dhe J. R. kanë pësuar lëndime të rënda trupore. Në ndërkohë paditësi J. R. ka ndërruar jetë para se aktgjykimi i shkallës së parë të bëhej i plotfuqishëm dhe Gjykata

e shkallës së dytë e ka prishur aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka kthyer në rigjykim. E autorizuara e paditësve ka bërë precizimin e kërkesë padisë në të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit jomaterial dhe material për Sh. R. dhe B. R. që të dy nga fsh.K. KK Prizren më afér të përshkruara në parashtresën për precizimin e kërkesë padisë të dt. 28.11.2011. Pasi që Gjykata Supreme me ravizion e ka kthyer lëndën në rigjykim e autorizuara e paditës të shqyrtim ka aritur marëveshje me të autorizuarin e të paditurit dhe janë pajtuar që shqyrtimi të vazhdojë vetëm sa i përket paditës Sh. R. dhe atë për kompensim për fitimin e humbur –rentës , kurse sa i përket formave tjera të kompensimit janë dakorduar që mos të kërkojnë kompensim për nsihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar dhe shërimin klimatik për të dy paditësa. Në fjalën e fun dit e autorizuara e paditës ka mbetur pranë kërkesës për kompensim për fitim të humbur duke pasur parasysh se paditësja me me profesionin eshtë robaqepëse dhe për shkak të aksidentit nuk ka mundur që të ushtrojë profesionin e saj dhe nuk ka mundur që të fitojë të ardhura si para aksidentit . Këtë gjendje e ka llogaritur edhe aktuari i angazhuar nga ana e gjykatës i cili ka dhënë mendimin e tij bazuar në prova të parashtruara , kurse sa i përket vërtetimit të biznisit dhe rregjistrimit eshtë fakt se ajo nuk ka pasur të rregjistruar, por se ka punuar kanë vërtetuar dëshmitarët e dëgjuar. Ka propozuar që gjykata ta aprovojë kërkesëpadinë dhe të aprovojë të njejtën bazuar në mendimin e aktuarit në shumë prej 9.258,87€ me kamatë ligjore që nga dita e mbajtjes së shqyrtimit kryesor. I ka kërkuar shpenzimet për dy shqyrtime të mbajtura me nga 180€.

I autor. i të paditurës, ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe në shqyrtimin e parë pasi që lënda eshtë kthyer në rigjykim ka aritur marëveshje me të autorizuaren e paditës sa i përket kompensimit të dëmit jomaterial për ndihmën e personit të tretë, ushqimit të përforcuar dhe shërimit klimatik, duke konsideruar se këto çështje janë zgjedhur , kurse ka vazhduar shqyrtimin dhe ka kontestuar faktin e kompensimit të dëmit jomaterial për fitimin e humbur sa i përket paditës Sh. R. Në fjalën e tij të fundit i atuor. I të paditures ka deklaruar se sa i përket fitimit të humbur gjykata e shkallës së parë në rigjykim veproi në kundërshtim me sygerimet e dhëna nga Gjykata Supreme pasi që eshtë dashur që të vërtetohet veprimtaria e paditës Sh. R. si rrobaqepëse se a ka qenë e regjistruar dhe a ka paguar tatim dhe kontributet për ushtrimin e veprimtarisë së saj. Andaj renta e gjykuar më parë eshtë e padrejtë dhe e pabazuar në prova materiale ku përveç shumave të tjera për format e dënimit që janë ekzekutuar edhe shuma e kërkuar për fitimin e humbur rentën eshtë ekzekutuar padrejtësisht prandaj ka propozuar që gjykata a refuzoj kërkesë padinë e paditës si të pabazuar dhe duke pasur parasysh se kjo shumë eshtë ekzekutuar e paditura e mbanë të drejtën që të kërkoj kundërpërmbarim në procedurën përmbarimore sa i përket shumës së ekzekutuar në lartësi prej 9.258,87€. Sa i përket shpenzimeve procedurale propozon që gjykata të vendos bazuar në nenin 452.2 të LPK.

#### **Vlerësimi provave**

Gjykata pas vlerësimit të deklaratave të palëve dhe pas vlerësimit të çdo prove të administruar në kuptim të nenit 8 të LPC ka gjetur se

### **Kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.**

Për vërtetimin e gjendjes faktike janë administruar këto prova:ka bërë dëgjimin e dëshmitareve M<sub>1</sub> R<sub>1</sub> nga fsh K<sub>1</sub>, A<sub>1</sub> R<sub>2</sub> nga fsh.N<sub>1</sub> dhe V<sub>1</sub> M<sub>2</sub> D<sub>1</sub> nga fsh.Korishë si dhe ka bërë shiqimin në ekspertizën e ekspertit të aktuaristikës A<sub>2</sub> B<sub>1</sub> nga Prishtina dhe ka bërë shiqimin në diplomën e Qendrës për arsim profesional për paditësen.

Me ndëgjimin e dëshmitareve M<sub>1</sub> R<sub>1</sub> nga fsh. K<sub>1</sub>, A<sub>1</sub> R<sub>2</sub> nga fsh. N<sub>1</sub> dhe V<sub>1</sub> M<sub>2</sub> D<sub>1</sub> nga fsh.K gjykata vërtetoi se të njëjtat janë bashkëfshatare me paditësen Sh<sub>1</sub> R<sub>1</sub> dhe që të triyat kanë qepur fëstana dhe qezi tek paditësja pasi që e njëjta ka qenë rrobaqepëse më e mirë në fshat dhe ka qepur edhe punë dore me grep të cilat paditësja i ka kryer për kompensim. Dëshmitarja V<sub>1</sub> M<sub>2</sub> D<sub>1</sub> ka cekur se ajo gjithashtu punon si rrobaqepëse dhe ka shkuar te Sh<sub>1</sub> që të mësoj në fillim të punës së saj dhe paditësja e ka mësuar që të qëndisë si dhe të qepi fustana dhe funda pasi që Sh<sub>1</sub> ka qenë më e mira dhe ka pasur më shumë punë për këtë edhe e ka zgjedhur që të mësohet tek ajo. Dëshmitaret kanë deklaruar se Sh<sub>1</sub> profesionin e saj e ka ushtruar në shtëpi dhe për këtë profesion është kompensuar respektivisht është paguar nga ana e dëshmitareve.

Me shiqimin në diplomën e Qendrës për aftësim profesional për paditësen për kryerjen e kursit të rrobaqepësisë nr.91 nr. i protokollit 554/94 të dt. 19.11.1994 gjykata ka konstatuar se Sh<sub>1</sub> R<sub>1</sub> e ka kryer kursin për rrobaqepësi në Qendrën për aftësim profesional "Dituria" në Prizren.

Me leximin e ekspertizës së dhënë nga ana e ekspertit të aktuaristikës A<sub>2</sub> B<sub>1</sub> nga Prishtina, gjykata ka vërtetuar se i njëjti e ka dhënë mendimin e tij në lidhje me fitimin e humbur dhe rentën e kapitalizuar për paditësen Sh<sub>1</sub> R<sub>1</sub> e cila nuk ka mund të ushtrojë profesionin e saj për periudhën e kaluar dhe të ardhshme pasi që ka pasur lëndime në aksidentin e komunikacionit dhe sipas konstatimit dhe mendimit të tij shuma e gjithmbarshme e rentës së kapitalizuar është vlera prej 9.258,87 Euro

### **Vlerësimi juridik**

Gjykata duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së Revisionit i administroi provat sa i përket faktit se Sh<sub>1</sub> R<sub>1</sub> profesionin e saj të rrobaqepësisë a e ka ushtruar dhe si e ka ushtruar duke pasur parasysh se është kontestuese fakti që paditësja ka punuar si rrobaqepëse në shtëpi dhe jo e lajmëruar dhe e regjistruar.Në këtë drejtim gjykata e ka obliguar të autorizuaren e paditëses që të siguroj prova sa i përket regjistrimit dhe pagesës së tatimit si dhe provat tjera.E autorizuara e paditëses ka edhe një herë ka cekur se paditësja nuk ka qenë e lajmëruar dhe e regjistruar por ak ushtruar veprimtari në shtëpi dhe me këtë veprimtari ajo ka pasur përfitime materiale.Në këtë drejtim edhe janë propozuar dëshmitarët të cilët gjykata i ka dëgjuar.Gjykata duke u nisur nga fakti se veprimtaria e rrobaqepësisë në të shumtën e

rasteve nuk lajmërohet dhe nuk regjistrohet dhe nga kjo rrjedh edhe se nuk paguhet tatimi në punë konsideron se edhe rasti i Shqipërisë është i tillë. Se paditësja ka punuar kanë dëshmuar tri dëshmitare njëra prej të cilave edhe ka mësuar profesionin e rrobaqepësisë tek paditësja të cilave gjykata ia fali besimin dhe e pranoi faktin se paditësja ka ushtruar një veprimitari të rrobaqepësisë e cila për shkak të aksidentit i është ndërprerë dhe me këtë i është ndërprerë edhe fitimi. Bazuar në këtë dhe pasi që gjykata e pranoi faktin se paditësja ka ushtrua aktivitetin e vet edhe është administruar dhe pranuar si provë mendimi i aktuarit i cili ka llogaritur se paditësja ka fituar një rrogë mesatare aftësia e të cilës është zvogluar për 30% andaj edhe puna reduktohet në këtë përqindje. Se veprimitaria e rrobaqepësisë si profesion ushtrohet në shtëpi e ka pranuar edhe eksperti aktuaristikës si një fakt i ditur botërisht aq më shumë në fshatra ku gratë ushtrojnë profesionin e tyre. Andaj gjykata bazuar në të lartcekurat si dhe në nenin 136 të LMD mbi shkaktimin e dëmit, neni 137.2 LMD lloji i dëmit si fitim i humbur, neni 159 LMD përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje, neni 173 LMD mbi dëmin real dhe fitimin e humbur si dhe neni 179.2 të LMD mbi shpërblimin e dëmit në rast të dëmtimit të shëndetit për shkak të paaftësisë së pjesshme kur personi humb fitimin atëherë personi përgjegjës ka për detyrë të paguaj rentën e caktuar në të holla si shpërblim për këtë humbjesi dhe nenet 918,919 dhe 923 të LMD të cilat parashohin sigurimin dhe rastet e siguruara tek shoqëria e sigurimit.

Andaj me sa u tha më lart në bazë të rezultateve të procedurës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452.1 të LPK, pasi që pala e cila humb procesin gjyqësor ka për detyrë që palës kundërshtare t'i kompensojë këto shpenzime gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.958/13 të dt. 13.03.2014**

Gjyqtaria  
*Shpresë Emra*

**ËSHILLA JURIDIKE;** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh, pas marrjes të të njëjtë, Gjykatës së së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.